

Sqarimet për Formularin „Informatat për shkollën fillore“ për PRINDËR

Qëllimi është, përcjellja individuale e çdo fëmije gjatë arsimit dhe zhvillimit, gjatë kohës kalimtare për në shkollë. Prindërit, Çerdhja dhe Shkolla janë partner në përgjegjësinë e përbashkët për fëmijën që do të hyjë në shkollë. Nëse ata bashkëpunojnë mirë, fëmija do të e ketë më të lehtë të e kaloj periudhën kalimtare për në shkollë.

Formulari¹ është një procedurë e praktikueshme për të i lidhur aftësitë pedagogjike të Çerdhes dhe të shkollës fillore. Aj e lehtëson bashkëpunimin, veçanërisht atëherë, kur nuk janë të mundura bisedat e përbashkëta me të gjitha palët e përfshira (për shembull kur kemi të bëjmë me një territor të gjerë që e mbulon Çerdhja dhe/ose të shkollës, në rastin kur fëmija e ndërron vendbanimin.

- Formulari ka për qëllim prezantimin e interesave të veçanta dhe pikave të forta të fëmijës.
- Aj njëkohësisht tregon, se në çka duhet më shumë të kihet kujdes në përcjelljen e mëtutjeshme të fëmijës.
- Formulari e përmban mendimin e Prindërve dhe të Çerdhes për kohën dhe vendin e „duhur“ për regjistrim në shkollë. Punëtorët profesional pedagogjik, në çerdhe munden të e vrojtojnë fëmijën në situata të tjera, për ndryshe nga ajo që është e mundur për prindërit në shtëpi, dhe anasjelltas

Këshilla për pyetjet pas regjistrimit në shkollë. (Pyetja 5)

- Vendimin për pranimin në shkollë e merr udhëheqësija e shkollës. Bazë për këtë regjistrim është procedura e regjistrimit shkollorë, këtu merren për bazë edhe dëshira e prindërve dhe propozimet e çerdhes.
- Fëmijës të juaj duhet të i jepet mundësia dhe koha, që të përgatitet në mënyrën optimal për kalimin në shkollë. Nëse në mes juve dhe të çerdhes, vjen deri tek bindjet e ndryshme në lidhje me kohen, se kur duhet fëmija të e filloj shkollën, kjo mund të jetë një arsye që drejtuesit e shkollës, që ata fëmijën e juaj dhe situatën e tij të e vrojtojnë më saktësisht dhe të e zhvilluar pastaj një bisedë trepalëshe me juve dhe me personelin profesional përkatës.

Plotësimi i Formularit është një punë e përbashkët e çerdhes dhe prindërve. Përcjellja e Formularit deri në shkollë (në procedurën e regjistrimit në shkollë) bëhet nga prindërit. Si plotësimi i formularit nga prindërit ashtu edhe dorëzimi i formularit në shkollë nga ana e prindërve bëhet në mënyrë vullnetare. Nëse ky nuk i dorëzohet shkollës, mund të ndodhë që në klasën e 1. të humbet kohë e vlefshme për mësim të hershem të fëmijës.

¹Në krijimin e këtij formulari “Informatat për Shkollën Fillore” ndër të tjera kanë qenë të përfshirë Instituti shtetëror për pedagogji të hershme, të autorizuarit për mbrojtjen e të dhënave, nga ministria për kulturë dhe marrëdhënie sociale, si dhe të autorizuarit të provincës së Bavarisë për mbrojtjen e të dhënave.